



SHPJEGIME METODOLOGJIKE:

Turizmi paraqet shumë e raporteve dhe dukurive që dalin nga udhëtimi dhe qëndrimi i turistëve në një vend, ku udhëtimi dhe qëndrimi i tillë nuk do të bazohet në banim të përhershëm dhe nëse me to nuk është e lidhur kryerja e ndonjë veprimtarie ekonomike.

Turizmi ndërkombëtar paraqet shumë të raporteve dhe dukurive që rezultojnë në momentin kur turisti kalon kufirin shtetëror dhe qëndron në vendin tjetër më së paku një natë për shkaqe pushimi, rekreacioni apo ngjashëm.

Turist paraqet çdo person, i cili qëndron përkohësisht në një vend jashtë vendit të banimit të përhershëm dhe atje kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në ndonjë objekt tjetër akomodimi.

Turist vendas paraqet person me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, i cili qëndron përkohësisht në vend tjetër jashtë vendbanimit të përhershëm dhe kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në ndonjë objekt tjetër akomodimi për turistët.

Turist i huaj paraqet person me vendbanim të përhershëm jashtë Republikës së Maqedonisë, i cili qëndron përkohësisht në Republikën e Maqedonisë dhe kalon më së paku një natë në objekt hotelier ose në objekt tjetër akomodimi për turistët¹.

TË DHËNA STATISTIKORE
PËR NUMRIN E TURISTËVE DHE BUJTJEVE TË REALIZUARA NË KOMUNËN E STRUGËS
PËR PERIUdhËN KOHORE JANAR-DHJETOR 2017

Në bazë të të dhënave statistikore², numri i turistëve në vitin **2017** në Komunën e Strugës ka qëndruar gjithsej **77 238** turistë, prej të cilëve **37 928** janë turistë vendas, kurse numri i turistëve të huaj ka qenë **39 310** turistë. Në vitin 2017 janë realizuar gjithsej **330 489** bujtje, prej të cilave **200 666** nga ana e turistëve vendas, kurse turistët e huaj kanë realizuar gjithsej **129 823** bujtje.

Tabela nr. 1, Numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara në Komunën e Strugës për vitin 2017

Numri i turistëve dhe bujtjeve të realizuara për vitin 2017	Turistë			Bujtje të realizuara		
	Gjithsej	Vendas	Të huaj	Gjithsej	Vendas	Të huaj
Gjithsej	77 238	37 928	39 310	330 489	200 666	129 823

Burimi: Enti Shtetëror Statistikor, Shkup, 2017

Sipas numrit të turistëve të huaj që kanë qëndruar në Strugë në vitin 2017, vendin e parë e kanë zënë turistët nga **Republika e Turqisë** me **7 686** turistë, në vend të dytë **Mbretëria e Holandës** me **6 058** turistë, kurse në vend të tretë është **Republika e Kosovës** me **3 757** turistë. Nga gjithsej **39 310** turistë të huaj, **17 501** turistë (gjegjësisht **44.5%**) bëjnë pjesë nga shtetet e lartpërmendura. Sipas numrit të bujtjeve të realizuara, nga gjithsej **129 823** bujtje, në vend të parë ka qenë **Mbretëria e Holandës** me **45 302** bujtje, në vend të dytë **Republika e Izraelit** me **14 151** bujtje, kurse në vend të tretë **Republika e Polonisë** me **12 330** bujtje të realizuara. Shtetet që përmenden më lartë marrin pjesë me **55.3%** në numrin e përgjithshëm të bujtjeve të realizuara.

¹ Definicionet për turistin, turistin e vendit dhe turistin e huaj janë dhënë në bazë të shpjegimeve metodologjike që jep Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë me seli në Shkup (për informacione më të hollësishme kliko në ueb-faqen e këtij enti: www.stat.gov.mk).

² Enti Shtetëror Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Të dhëna statistikore për Komunën e Strugës, Shkup, 2017, faqe 1.


Në vazhdim të këtij teksti do të paraqiten të dhënat për turistët e huaj që më së shumti e kanë vizituar dhe kanë qëndruar në Komunën e Strugës në vitin 2017, në rang-listë prej dhjetë shteteve.

Tabela nr. 2, Numri i turistëve të huaj dhe bujtjeve të realizuara në Komunën e Strugës për vitin 2017

Rang	Shteti	Numri i turistëve	Rang	Shteti	Bujtje të realizuara
1.	Turqia	7 686	1.	Mbretëria e Holandës	45 302
2.	Mbretëria e Holandës	6 058	2.	Izraeli	14 151
3.	Kosova	3 757	3.	Polonia	12 330
4.	Shqipëria	3 738	4.	Turqia	9 633
5.	Izraeli	2 912	5.	Belgjika	7 729
6.	Polonia	2 774	6.	Kosova	6 691
7.	Bullgaria	2 176	7.	Shqipëria	6 379
8.	Greqia	1 208	8.	Bullgaria	4 333
9.	Belgjika	1 022	9.	Greqia	2 549
10.	Serbia	768	10.	Serbia	1 974
Gjithsej:		32 099	Gjithsej:		111 071

Nga gjithsej **39 310** turistë të huaj që kanë qëndruar në Strugë gjatë vitit 2017, mbi **81.6%** iu përkasin turistëve që vijnë nga dhjetë shtetet e lartpërmendur. Sa i përket bujtjeve të realizuara nga ana e turistëve të huaj (**129 823 bujtje**), mbi **85.5%** të bujtjeve iu përkasin këtyre turistëve.

Paraqitja grafike nr. 1, Numri i turistëve sipas muajve të vitit 2017



Paraqitja grafike nr. 2, Bujtje të realizuara sipas muajve të vitit 2017

